




SHOQATA E PENSIONISTËVE TË TMK / FSK &
SIMPATIZANTËVE
SHP TMK / FSK & S., „ELITA” – DEGA E NERODIMËS
KPC / KSF PENSIONERS ASSOCIATION AND
SYMPATHISTS
KPC / KSF & S., „ELITA”- NERODIME BRANCH



KOMUNA E HANIT TË ELEZIT
MUNICIPALITY OF HANI I ELEZIT

Nr. Prot. (/ /2023)



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të Komunës së Hani të Elezit dhe Shoqatës së Pensionistëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës / Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Simpatizantëve (SHP-TMK-FSK-së) „ELITA” – Dega e Nerodimes

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Palët nënshkruese, bien dakord të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre dhe të krijojnë një kuadër të favorshëm për bashkëpunim, me qëllim realizimin e objektivit dhe përgjegjësisë së përbashkët. Objektivit i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe vendosja e ndërveprimit të përbashkët mes palëve.

Neni 2

Përgjegjësitë

Sipas kësaj marrëveshjeje SHP TMK-FSK-së dhe Simpatizantëve „ELITA” merr përsipër:

- Të analizojë nevojat dhe mundësitë e bashkëpunimit rreth çështjeve të interesit të përbashkët nga fusha e menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe të tjera;
- Të afrojnë ndihmë dhe mbështetje në rast të çfarëdo kërcënimi apo rreziku në raste emergjente për vendin dhe qytetarët;
- Të dakordohet me komunën lidhur me përgjegjësitë konkrete në misionet e përbashkëta;
- Të afrojnë shërbime profesionale përmes trajnimeve të përbashkëta ose mbështetje;
- Të organizojë simpoziume dhe tryeza të përbashkëta lidhur me çështjet e interesit të përbashkët;
- Të vlerësojë, sipas kërkesave të komunës, terrenet me rrezik nga rrëshqitjet e dheut, nga orteqet e borës, nga pëmblytjet etj.
- Të organizojë fushata vetëdijësuese për nxënës nëpër shkolla si dhe për të rriturit rreth rrezikut nga mjetet e pashpërthyer, nga zjarri etj;
- Të organizojë fushata vetëdijësuese për fëmijë, nxënës dhe të rritur për detektim dhe menaxhim të mjeteve të rrezikshme kimike;
- Të organizojë punëtori për aftësimin e të rinjëve dhe ekipeve të kërkim shpëtimit për përdorimin e busullës dhe orientimin në natyrë (përdorimi i hartave);
- Të trajnojnë ekipet e kërkim shpëtimit në male, në vendet urbane, rurale, në ujëra si dhe në raste të tërmeteve.
- Të organizojë trajnime fushore.

Neni 3

Obligimet e komunës

- Të sigurojë një zyre për punë brenda mundësive që ka komuna;
- Të sigurojë mbështetjen financiare për aktivitetet e shoqatës që lidhen me këtë marrëveshje,
- Të sigurojë hapësira pune – salla të përshtatshme për trajnime, ligjërata etj.
- Të afrojë ndihmë teknike - paisje për nevoja të shoqatës.

Neni 4

Detyrimet e shoqatës

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, Shoqata „ELITA”, merr përsipër:

- Që me përgjegjësi të plotë morale e materiale, t'i dal zot përgjegjësive dhe detyrimeve për të cilat dakordohen me këtë marrëveshje.
- Të vërë në dispozicion potencialet dhe kapacitetet e veta njerëzore e materiale teknike të cilat i disponon dhe t'i vendos në shërbim të misionit për të cilin obligohet sipas kësaj marrëveshjeje.
- Të bashkërendojë punët, veprimet dhe përgjegjësitë e çështjet tjera, për të cilat dakordohen palët me këtë marrëveshje.

Neni 5

Zgjidhja e Marrëveshjes

- Marrëveshja përfundon me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 6 të kësaj marrëveshje.
- Marrëveshja mund të shkëputet përpara afatit të paracaktuar, duke njoftuar paraprakisht palën tjetër kontraktuese me shkrim, të paktën një muaj përpara, me dakordimin e dyja palëve.

Neni 6

Afati i marrëveshjes

- Kohëzgjatja e marrëveshjes është tre (3) vite me mundësi zgjatjeje dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
- Çdo përshtatje, modifikim ose ndryshim i tekstit të kësaj marrëveshje, që propozohet nga palët nënshkruese, kërkon aprovimin me shkrim të palëve.

Neni 7

Mosmarrëveshjet

- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet palëve, sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshje, do të arrihet me mirëkuptim dhe ndërmjet diskutimeve mes palëve nënshkruese. Në rastin kur palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 8

Baza ligjore


1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenit 65 (1);
2. Ligji Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
3. Ligji nr. 06/L- 043 Për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare /Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 11 / 24 prill 2019, Prishtinë/
4. Neni 1 pika 6 e Statutit të Shoqatës së Pensionistëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës / Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Simpatizantëve „ ELITA”.

Neni 9


Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje, hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj dhe shtypet në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore nga të cilat dy kopje mbahen në shoqatë dhe dy kopje mbahen në komunë.

Si më sipër u lexua, aprovua dhe u nënshkrua nga palët më datë, 15/12/2023.



Imri AZEMI
Kryetar
SHP TMK-FSK-së & S - „ELITA”
Dega e Nerodimes - FERIZAJ



Mehmet BALLAZHI
Kryetar
Komuna HANI ELEZIT



Neni 8

Baza ligjore


1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenit 65 (1);
2. Ligji Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
3. Ligji nr. 06/L- 043 Për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare /Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 11 / 24 prill 2019, Prishtinë/
4. Neni 1 pika 6 e Statutit të Shoqatës së Pensionistëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës / Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Simpatizantëve „ ELITA”.

Neni 9


Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje, hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj dhe shtypet në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore nga të cilat dy kopje mbahen në shoqatë dhe dy kopje mbahen në komunë.

Si më sipër u lexua, aprovua dhe u nënshkrua nga palët më datë, 15/12/2023.



Imri AZEMI
Kryetar
SHP TMK-FSK-së & S - „ELITA”
Dega e Nerodimes - FERIZAJ



Mehmet BALLAZHI
Kryetar
Komuna HANI ELEZIT

